



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE TË
MINISTRISË SË FINANCAVE**

PËR VITIN 2019

Prishtinë, Korrik 2020

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë llogaridhënien e institucioneve publike, duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur për opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të *Ministritë së Financave* në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm *Qerkin Morina*, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga *Udhëheqësi i ekipit Jusuf Kryeziu dhe anëtarët e ekipit Shehrije Shala, Ariana Gjonbalaj, Mehmet Muçaj dhe Ramadan Gashi*, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit *Blerim Kabashi*.


TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore	7
2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	8
3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	17
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	20
Shtojca II: Letër Konfirmimi	23

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti i përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) të Ministrisë së Financave (MF) për vitin 2019, i cili përfshin edhe Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për këto Pasqyra. Ekzaminimi i Pasqyrave Financiare për vitin 2019 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA).

Auditimi është fokusuar në:



Konkluzionet

Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Financave për vitin 2019, respektivisht Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, Pasqyra e ekzekutimit të buxhetit dhe Shpalosjet për këto pasqyra, janë të plota dhe të sakta (përveç nenit 20 avancet e pa mbyllura - Çështja A1 në brendi të raportit).

Menaxhimi financiar dhe kontrolli në përgjithësi dëshmon një proces të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve tjera të kontrollit. Megjithatë, përkundër faktit se MF ka vendosur kontrole relativisht të mira në raport me obligimet statutores të saj, mos zbatimi me konsistencë i rregullave, ka shkaktuar mangësi në disa procese, veçmas në menaxhimin subvencioneve dhe menaxhimin e personelit.

Sa i përket zbatimit të rekomandimeve, MF ka treguar një përkushtim të lartë në adresimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e auditimit për PVF-të e vitit 2018, dhe nga gjashtë (6) rekomandimet e dhëna, vetëm një (1) nuk ishte adresuar ende. Megjithatë, edhe këtë vit mangësitë e njëjta janë vërejtur në menaxhimin e personelit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm¹

Opinion i pamodifikuar

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Financave për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, paraqesin pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

Më gjerësisht, shih kapitullin¹ të këtij raporti.

¹ Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Ministria e Financave është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar së do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna.

Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshinë ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave të tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Auditimi është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Ministrisë së Financave, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP).

Procedurat kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale, si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që i kemi konsideruar të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Gjetjet e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e dobësive që mund të ekzistojnë apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që janë aplikuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përshkrim të detajuar të gjetjeve dhe rekomandimeve në çdo fushë të audituar.

1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore

Ne kemi kryer auditimin e PFV-ve të Ministrisë së Financave për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019, në përputhje me Ligjin e ZKA dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Ekzaminimet e auditimit janë kryer për të mundësuar dhënien e opinionit për PFV, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme dhe pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, të shpalosura në detaje.

1. Opinion i pamodifikuar

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Financave për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me SNISA-t 10 dhe 30, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA në punën e saj është e pavarur nga subjektet e audituara. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV-të

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave (MF) është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministri është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Financave.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV-të në bazë të auditimit të kryer, në përputhje me SNISA-t. Këto standarde kërkojnë që të marrim siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keqdeklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

Ne komunikojmë me menaxhmentin e entitetit të audituar në lidhje me fushëveprimin, kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Raporti i auditimit publikohet në webfaqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Ne vlerësojmë lart bashkëpunimin korrekt të menaxhmentit dhe stafit të Ministrisë së Financave dhe ndihmën e ofruar gjatë procesit të auditimit.

2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore, pasuritë, detyrimet, si dhe funksionin e auditimit të brendshëm.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Ministria e Financave (MF) në vazhdimësi ka treguar gatishmëri në përmirësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit me qëllim të arritjes së objektivave të përcaktuara. Rezultatet tona të auditimit kanë nxjerrë në pah se MF ka vendosur kontrolle adekuate në shumicën e aktiviteteve operative dhe financiare.

Kontrollet mbi menaxhimin e përgjithshëm të procesit buxhetor, marrë si tërësi, janë të mira. Megjithatë, kontrollet në kategorinë e subvencioneve dhe menaxhimin e pasurive duhet të

përmirësohen, ndërsa kontrollet në fushën e menaxhimit të të hyrave dhe shpenzimeve janë funksionale dhe zbatohen në mënyrë efektive.

Më tej, në aspektin e pajtueshmërisë me legjislacionin, auditimi ynë ka shpalosë ekzistencën e disa dobësive të cilat përfshinë kryesisht menaxhimin e personelit, menaxhimin e subvencioneve dhe menaxhimin e pasurive.

Në vlerësimin tonë Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) në vazhdimësi demonstroi një cilësi të mirë të punës përmes së cilës ofron siguri të arsyeshme lidhur me funksionimin e kontrolleve në organizatë. Në këtë aspekt, përfitimi nga puna e auditimit të brendshëm duhet të merret në konsideratë nga menaxhmenti i MF-së për përmirësimin e fushave me mangësi.

2.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti Fillestar	Buxheti Final2	2019 Realizimi	% e realizimit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Burimet e Fondeve:	73,618,595	46,276,926	31,299,912	68	27,351,666	23,125,136
Granti i Qeverisë -Buxheti	65,778,595	40,398,134	29,222,562	72	26,958,879	22,813,721
Financimi nga huamarrja	3,000,000	3,000,000	0	0	0	0
Financimi përmes klauzolës së investimeve	500,000	500,000	0	0	0	0
Te hyrat nga AKP	4,340,000	1,933,000	1,682,082	87	0	0
Donacionet e jashtme	0	445,792	395,268	89	392,787	311,415

Në vitin 2019, Ministria e Financave ka shpenzuar 31,299,912€ ose rreth 68% të buxhetit final, duke përfshirë Doganën dhe Administratën Tatimore të Kosovës. Ministria e Financave (përfshirë Doganën dhe ATK), gjatë vitit ka shpenzuar 11,097,629€. Krahasuar me buxhetin final i cili ishte 24,070,734€, kishte një përqindje të ulët të realizimit për shkak që në buxhet janë përfshi edhe (buxheti për kontingjencat dhe për fondin zhvillimor për komunat veriore).

2) Buxheti Final – Buxheti i aprovuar nga Kuvendi dhe më pas i përshtatur nga Ministria e Financave

Nëse nga buxheti i MF për qëllime të matjes së performancës buxhetore në raport me realizimin e zbresim buxhetin për kontingjenca në vlerë prej 4,682,986€ dhe buxhetin për Fondin zhvillimor në vlerë prej 3,972,850€, del se buxheti nga MF është realizuar 72%. Buxheti për kontingjenca dhe për Fondin zhvillimor të komunave veriore nuk janë të parapara për mbështetjen e aktiviteteve të rregullta të MF-së andaj për qëllime të vlerësimit të performancës buxhetore në nivel të kategorive, nuk do të merren për bazë.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Realizimi	% e Realizimit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	73,618,595	46,276,926	31,299,912	68	27,351,666	23,125,136
Pagat dhe Mëditjet	16,874,241	16,577,555	16,511,716	100	16,165,796	15,034,273
Mallrat dhe Shërbimet	27,891,310	8,107,290	6,331,095	78	5,466,262	5,004,579
Shërbimet komunale	588,592	455,391	287,194	63	306,571	311,315
Subvencione dhe Transfere	13,020,000	9,087,925	2,055,509	23	2,722,290	1,241,086
Investimet Kapitale	15,244,452	12,048,765	6,114,398	51	2,690,747	1,533,883

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore të Ministrisë së Financave, pa Doganën dhe Administratën Tatimore të Kosovës:

Buxheti fillestar për paga dhe mëditje ishte 3,054,845€, ndërsa ai final 2,902,506€. Buxheti final ishte zvogëluar për 152,339€ në bazë të Vendimit të Qeverisë Nr. 03/15 datës 17.12.2019.

Buxheti fillestar për Mallra dhe Shërbime ishte 22,847,851€ (përfshirë edhe kontingjencat prej 19,448,020€) ndërsa ai final ishte 3,399,831€. Përveç kontingjencave, nuk kishte ndryshime të buxhetit final në raport me atë fillestar. Realizimi vjetor i buxhetit në këtë kategori ishte 1,998,644€, që shprehur në përqindje ishte rreth 59%. Në shumën prej 3,399,831€ është i përfshirë edhe buxheti nga programi i kontingjencës në vlerë prej 682,986€ të cilat nuk ishin transferuar në organizata buxhetore dhe në fund të vitit, kishin mbetur fonde të lira. Nëse nga buxheti final e zbresim buxhetin për kontingjenca në vlerë prej 682,986€, del se buxheti është shpenzuar rreth 74%.

Buxheti fillestar për shpenzime komunale ishte 123,521€, ndërsa ai final 36,321€, nga të cilat ishin shpenzuar 27,200€, apo shprehur në përqindje rreth 75%. Buxheti final krahasuar me buxhetin fillestar është zvogëluar për 87,200 në bazë të Vendimit të Qeverisë Nr. 03/15 datës 17.12.2019.

Buxheti fillestar për Subvencione dhe transfere ishte 13,020,000€, nga të cilat 10,000,000€ ishin kontingjencat e MF, ndërsa ai final ishte zvogëluar në 9,087,925€ apo për 3,932,074.88€. Ky zvogëlim i buxhetit ishte si rezultat i deklarimit të MF si kursime buxhetore në mbyllje të vitit fiskal.

Realizimi vjetor i buxhetit në këtë kategori ishte 2,055,509€, ndërsa në shumën prej 9,087,925€ është i përfshirë edhe buxheti nga programi i kontingjencës në vlerë prej 4,000,000€ të cilat nuk ishin transferuar në organizata buxhetore, dhe në fund vit kishin mbetur fonde të lira, si dhe shuma e buxhetuar prej 3,000,000€ në programin e Thesarit për projektin “*Forcimi i sektorit financiar*”. Kontrata ishte nënshkruar me Asociacionin Ndërkombëtar për Zhvillim (ANZH), mirëpo nuk ishte ratifikuar në Kuvend, andaj nuk kishte filluar realizimi i këtij projekti, si dhe shuma prej 32,416€ kanë mbetur mjete të pa shpenzuara në fund të vitit.

Buxheti fillestar për investimet kapitale ishte 8,594,452€, ndërsa ai final 8,644,151€, ndërsa ishin shpenzuar 4,165,844€, apo rreth 48%. Buxheti final krahasuar me buxhetin fillestar është rritur për 49,699€, prej tyre 43,301€ janë zvogëluar prej Grantit Qeveritar, ndërsa është rritur për 93,000 prej të hyrave nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP).

Në buxhetin final prej 8,644,151€ është i përfshirë edhe buxheti nga Fondi zhvillimor i mirëbesimit për komunat veriore 3,972,850€, fonde të cilat nuk janë transferuar në komunat përkatëse dhe kanë mbetur si mjete që barten për shpenzim në vitin tjetër. Nëse nga buxheti final zbritet buxheti nga kontingjencat në vlerë prej 3,972,850€, atëherë shkalla e shpenzimeve të buxhetit është 89%.

2.1.1 Të hyrat

Ministria e Financave, përfshirë Doganën dhe ATK-në, për vitin 2019 ka realizuar të hyra neto prej 1,638,510,109€, ndërsa vetëm MF ka realizuar 188,972€, të hyra që kanë të bëjnë me gjobat ndaj institucioneve financiare dhe gjoba tjera, të hyrat nga licencimi i aktiviteteve individuale dhe të lira. Në tabelën vijuese janë paraqitur të hyrat totale të MF-së.

Të hyrat nga DK dhe ATK nuk janë pjesë e këtij raporti, pasi që ato trajtohen në raporte të veçanta.

Tabela 3. Të hyrat tatimore dhe jo tatimore dhe kthimet (në €)

Agjencitë / Departamenti	Të hyrat bruto	Kthimet	Të hyrat neto 2019	Të hyrat 2018	Të hyrat 2017
Dogana	1,179,586,032	(1,786,817)	1,177,799,215	1,130,784,498	1,111,953,000
ATK	504,281,904	(43,759,982)	460,521,921	424,739,809	365,917,000
Thesari	63,000	0	63,000	55,000	265,200
NJIF	47,577	0	47,577	0	20,000
Administrata Qendrore	78,396	0	78,396	89,690	88,465
Totali:	1,684,056,909	(45,546,799)	1,638,510,109	1,555,668,997	1,478,243,665

Në vitin 2019 të hyrat totale neto në MF, DK dhe ATK janë 1,638,510,109€, që krahasuar me vitin paraprak kanë shënuar rritje për 82,841,112 € apo 5.3%. Rritje kishte në të hyrat tatimore të ATK për 35,782,112€ dhe në Doganë 47,014,717€, ndërsa vetëm të hyrat në MF janë rritur për 44,283€ në krahasim me vitin 2018.

Në fushën e të hyrave, ne kemi testuar gjashtë (6) mostra për teste substanciale në vlerë 107,098€, dhe gjashtë (6) mostra për teste të pajtueshmërisë. Testet tona nuk kanë identifikuar parregullsi në këtë fushë.

2.1.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për Pagat dhe mëditje ishte 2,902,506€, prej të cilave ishin shpenzuar 2,850,433€. Numri i planifikuar i të punësuarve sipas buxhetit ishte 347, ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 309. Ne gjithashtu kemi bërë krahasime të shpenzimeve ndërmjet sistemit informativ financiar të Kosovës (SIMFK) dhe sistemit të pagave, dhe nuk kemi hasur në ndonjë mosbarazim sa i përket regjistrimit dhe raportimit të shpenzimeve për paga.

Në fushën e pagave, ne kemi testuar 71 mostra për teste substanciale në vlerë 42,433€, dhe pesë (5) mostra për teste të pajtueshmërisë. Testimet tona nuk kanë identifikuar ndonjë parregullsi në këtë fushë.

2.1.3 Mallrat dhe shërbimet

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2019 ishte 3,436,152€ (përfshirë edhe komunalitë 36,321€). Prej tyre ishin shpenzuar 2,025,844€ (komunali 27,200€). Ato kanë të bëjnë kryesisht me mirëmbajtje të teknologjisë informative, furnizim me pajisje tjera, furnizime për zyrë, karburant për vetura zyrtare dhe për ngrohje qendrore, sigurimi i ndërtesave tjera dhe qiraja për ndërtesa.

Ne kemi testuar 45 mostra për teste substanciale në vlerë 748,646€ si dhe gjashtë (6) mostra për teste të pajtueshmërisë. Testimet tona kanë identifikuar parregullsitë si në vijim:

Çështja A1 – Avanset e pambyllura në SIMFK nga vitet paraprake

Gjetja Sipas Udhëzimit Administrativ nr. 2004/07 për udhëtime zyrtare neni 8, avanset për udhëtime zyrtare duhet të mbyllën dhe shumat e pashpenzuara duhet të kthehen në llogarinë bankare brenda 15 ditësh pas kthimit nga udhëtimi zyrtar.

Bazuar në procesin e pajtueshmërisë dhe harmonizimit të shënimeve në SIMFK dhe regjistrave kontabël në mes Thesarit dhe Departamentit qendror në MF, sipas të dhënave të ofruara nga zyrtarët përgjegjës në MF, kemi vërejtur se shuma e avanseve të hapura në sistem ishte 15,417€

MF kishte dërguar shkresa në Thesar që tregonin mbylljen e avanseve nga vitet paraprake, mirëpo në sistem ato ende kishin mbetur të hapura. Nga korrespondencat (emali) vërehet se MF kishte bërë kërkesë në Thesar për t'i mbyllur, por avanset akoma mbeten të hapura në regjistra kontabël. MF në koordinim me Thesarin kishin ndërmarrë veprime dhe kanë formuar grupin punues me qëllim të barazimit dhe mbylljes së avanseve të cilat figurojnë në sistem si të hapura.

Kjo kishte ndodhur si pasojë e mos koordinimit të duhur në mes të zyrtarëve përgjegjës në MF dhe Thesarit, për mbylljen e avanseve në sistemin e regjistrave kontabël.

Ndikimi Mos mbyllja e avanseve në sistem – regjistra kontabël, ka ndikuar që llogaritë e avanseve të vazhdojnë të mbesin aktive nga viti në vit.

Rekomandimi A1 Ministri duhet të siguroj se do të merren masa që brenda një periudhe të shkurtër kohore të sqarohet problemi me avanse dhe se të gjitha llogaritë e viteve paraprake të mbyllën.

2.1.4 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 4,671,301€, ndërsa nga kjo shumë janë shpenzuar 4,165,844€. Në këtë shumë nuk është përfshirë buxheti i Fondit zhvillimor të mirëbesimit për komunat veriore në vlerë prej 3,972,850€. Shpenzimet kanë të bëjnë me pajisje të teknologjisë informative, softuer, pajisje tjera dhe dy pagesa sipas vendimeve gjyqësore në vlerë prej 2,684,452€.

Pagesat në vlerë prej 2,684,452 € janë bërë për shpronësimin e pronave tek rreth rrotullimi i stacionit të autobusëve. Pagesa ka ndodhur si rezultat i zbatimit të urdhrin përmbarrimor P nr. 962/15 i datës 13.03.2018 me debitor Ministria e Financave dhe kreditor Ndërmarrja Publike Banesore dhe me vendim të Ministrit të Financave nr. 37/2018 i datës 05.09.2018. Ministria e Financave në Ligjin e Buxhetit për vitin 2019 në tabelën 3.2 projekte kapitalë për nivele Qendrore e kishte përfshirë këtë obligim tek projektet kapitale “Përmbushja e Obligimeve sipas Vendimeve Gjyqësore”.

Në këtë kategori, ne kemi testuar 17 mostra për teste substanciale në vlerë 4,165,844€, si dhe pesë (5) mostra për teste të pajtueshmërisë në vlerë prej 441,352€. Testimet tona kanë identifikuar parregullsitë si në vijim.

Çështja A-2 Furnizim me kompjuterë për nevoja të AQP-së

Gjetja Sipas nenit 59.4 të LPP-së, autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Për më tej, në njoftimin për kontratë të datës 14.05.2019 “Furnizim me kompjuterë për nevojat e Agjencisë Qendrore të Prokurimit” ishte kërkuar që përveç tjerash, operatorët ekonomik duhet të ofrojnë katalog me ngjyra së bashku me specifikacionin teknik për pajisjet e ofruara.

Përkundër kësaj kërkesë, operatori ekonomik e kishte ofruar/ofertuar katalogun pa ngjyra. Ne kemi diskutuar me personat përgjegjës lidhur me këtë çështje në MF, mirëpo nuk është dhënë ndonjë shpjegim i arsyeshëm për mosrespektim të kësaj kërkesë.

Ndikimi Mangësitë e tilla gjatë procesit të vlerësimit rrisin rrezikun që të shpërblehen me kontrata operatorët ekonomik të cilët nuk i plotësojnë kriteret e paracaktuara. Kjo mund të ndikon që procesi i ekzekutimit të kontratës të karakterizohet me dobësi eventuale (mos përmbushje të kushteve të kontratës).

Rekomandimi A2 Ministri, duhet të siguroj që gjatë proceseve të prokurimit, Departamenti përkatës dhe personat tjerë të përfshirë në proces (komisioni i vlerësimit), të respektojnë në mënyrë të plotë kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë.

2.1.5 Subvencione dhe Transfere

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 5,087,925€, ndërsa shpenzimet ishin 2,055,509€. Ato kanë të bëjnë me subvencione për entitete publike, entitete jo publike dhe transfere tjera, siç ishte rasti me transferin për të ndihmuar Republikën e Shqipërisë me rastin e tërmetit të ndodhur.

Ne kemi testuar 33 mostra (të gjitha transaksionet e kryera të pagesave) për teste substanciale në vlerë 2,055,509€, si dhe pesë (5) mostra për teste të pajtueshmërisë në vlerë prej 883,000€. Testimet tona kanë identifikuar parregullsitë në vijim:

Çështja A3 - Shpenzimi i mjeteve nga fondit i shpenzimeve të paparashikuara

Gjetja Neni 29 i Ligjit nr.03/L-48 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësit, përcakton se nëse ndodhë një rast për të cilin nevojiten shpenzime urgjente ose të paparashikuara, organizata përkatëse buxhetore mund të aplikoj pranë Ministrisë të Financave për fonde shtesë. Në aplikacion, ndër të tjera duhet të shpjegohen rrethanat të cilat kanë shkaktuar nevojën për fonde shtesë, të shpjegohen arsyet pse këto rrethana nuk kanë mundur të parashikohen dhe të identifikohen propozim shfrytëzimet e fondeve të kërkuara.

Ne kemi vërejtur se nga pesë pagesat e testuara në vlerë 883,000€, në tri prej tyre si pasojë e nxjerrjes së vendimeve të Qeverisë³ për transferimin e mjeteve nga shpenzimet e paparashikuara (rezervë), në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve, nuk ishin respektuar procedurat e kërkuara të aplikimit për fonde shtesë në MF.

Për më tepër, natyra e shpenzimeve të ndodhura nuk ishte urgjente apo e shpenzimeve të paparashikuara, dhe rrjedhimisht këto shpenzime do të duhej të planifikoheshin në buxhetin e rregullt të MF-së dhe organizatave buxhetore përkatëse. Shpenzimet kishin të bënin me ndarjen e mjeteve financiare në vlerë 180,000€ për përkrahjen e realizimit të filmit „Lojë Jete“, 143,000€ për ndarjen e mjeteve financiare sipas kërkesës së Federatës së Xhudos së Kosovës, si dhe 50,000€ për një rast për mbulimin e shpenzimeve për shërim jashtë vendit.

Ndikimi Shpenzimi i mjeteve nga fondit i shpenzimeve të paparashikuara të cilat janë të përcaktuara për raste urgjente, për projekte të cilat duhet të planifikohen në buxhetin e rregullt, si dhe në mungesë të procedurës së kërkuar për aplikim në MF, rrezikon që MF të përballet me mungesë të buxhetit për trajtimin e situatave të paparashikuara (urgjente).

Rekomandimi A3 Ministri duhet të siguroj se në bashkëpunim me OB-të përkatëse, të bëj identifikimin dhe vlerësimin e kërkesave për projektet që drejtohen në MF dhe ZKM, dhe bazuar në vlerësimin e bërë për këto projekte, ato të planifikohen në buxhetin e rregullt të organizatave përkatëse buxhetore. Gjithashtu, të sigurohet se mjetet nga rezervat, duhet të ndahen vetëm për raste të paparashikuara (urgjente), në pajtueshmëri me procedurat e kërkuara sipas LMFP.

2.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale jo financiare mbi 1000€ ishte 9,096,031€. Prej tyre, 3,888,799€ janë pasuri e Doganës dhe 2,120,164€ të Administratës Tatimore të Kosovës, ndërsa vlera

³ (a) Vendimi i Kryeministrit nr. 09/89 i datës 12.02.2019; (b) Vendimi i Kryeministrit nr. 02/77 i datës 04.12.2019; dhe (c) Vendimi i Kryeministrit nr. 002/88 i datës 05.02.2019

neto e pasurive jo kapitale nën 1,000€ ishte 804,223€. Prej tyre 362,322 € janë pasuri të DK-së dhe 347,643€ janë të ATK-së. Ne kemi rishikuar nëse procesi i regjistrimit dhe mënyra e mbajtjes së evidencës është në pajtueshmëri me kërkesat e Rregullores MF nr. 02/2013, për menaxhimin e pasurisë jo financiare të organizatave buxhetore.

Menaxhimi i pasurisë në MF bëhet i pavarur në katër njësitë e saj: Administratën Qendrore, Thesar, Agjencinë Qendrore të Prokurimit (AQP) dhe Njësinë e Inteligjencës Financiare (NjIF). Testimet tona kanë identifikuar parregullsitë si në vijim:

Çështja A4 - Mangësi në menaxhimin e pasurisë

Gjetja Sipas rregullores së MF, nr.02/2013, për menaxhimin e pasurive jo financiare neni 16 pika 2 - Zyrtari i pasurisë jo financiare do t'i regjistrojë në mënyrën e duhur të gjitha pasuritë në regjistrin e pasurive dhe në regjistrat kontabël në bazë të dokumenteve që dëshmojnë se pasuria është në pronësi dhe mbikëqyrje të organizatës buxhetore.

Në Njësinë e Inteligjencës Financiare (NjIF), kemi vërejtur se pasuritë e blera në vitin 2019 në vlerë prej 4,384€ (tre laptopë nga 1,022€ dhe dy projektorë portable nga 658€), nuk janë regjistruar në regjistrin e pasurive. Gjithashtu, në NjIF kemi vërejtur që pasuria e blerë në vitin 2019 në vlerë prej 11,894€ nuk ishte regjistruar në mënyrën e duhur në regjistrin e pasurive dhe në regjistrat kontabël (dy Server të blerë, janë regjistruar në vlerën pa tatimin e vlerës së shtuar (TVSh) nga 5,506€, përderisa është dashur të regjistrohet edhe vlera për TVSh prej 440€ për njësi ose 881€ për dy serverë). Për këtë vlerë, pasuritë në regjistrat kontabël janë nënvlerësuar.

Ndikimi Mos regjistrimi i pasurive dhe regjistrimet e mangëta në regjistrin e pasurive dhe në regjistrat kontabël rrisin rrezikun ndaj humbjeve apo keqpërdorimit të tyre si dhe vlera e pasurisë së organizatës e pasqyruar në PFV të mos jetë e drejtë.

Rekomandimi A4 Ministri në bashkëpunim me menaxhmentin e NjIF-in duhet t'i rishikojnë kontrollet ekzistuese në menaxhimin e pasurisë. Kontrollet në këtë fushë duhet të forcohen në mënyrë që pasuritë të regjistrohen si duhet dhe të ruhen nga humbja dhe keqpërdorimi.

2.3 Detyrimet

2.3.1 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2019 ishte 29,533€ (nga këto 28,470€ ishin të Doganave, ndërsa shuma prej 1,063€ i përkasin MF-së). Këto detyrime janë bartur për pagesë në vitin 2020.

Ne testuam pesë (5) mostra për qëllime substanciale dhe pesë (5) të tjera për teste të pajtueshmërisë. Nga mostrat e testuara nuk kemi identifikuar ndonjë parregullsi.

2.3.2 Detyrimet kontraktuese

Bazuar në informatat e ofruara nga zyrtarët përgjegjës në MF janë si në vijim:

- MF-Administrata Qendrore, Thesar dhe NjIF, detyrimet kontraktuese në fund të vitit 2019 ishin 445,064€; dhe
- AQP - Prokurimet e centralizuara dhe prokurimet e veçanta, detyrimet kontraktuese në fund të vitit 2019 ishin 55,488,919€ (prej tyre prokurimet e centralizuara 54,982,592€, dhe prokurime të veçanta 506,327€).

2.4 Funkzioni i auditimit të brendshëm

MF ka një sistem funksional të auditimit të brendshëm që përbën një segment të rëndësishëm të kontrolleve në përgjithësi. Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) operon me gjashtë (6) anëtarë: Drejtori i NJAB-së, pesë (5) auditorë dhe një asistente. Është e organizuar në dy divizione: në atë për auditime në MF si dhe Divizioni për auditime jashtë MF-së, në entitete që nuk kanë të themeluara Njësinë e AB-së. NJAB kishte hartuar planin strategjik dhe vjetor. Në planin vjetor janë planifikuar 20 auditime gjatë vitit 2019 dhe që të gjitha ishin realizuar sipas planit të auditimit për vitin 2019.

Përmes këtyre raporteve NJAB i kishte ofruar informata menaxhmentit se sa efektive janë kontrollet e brendshme dhe funksionimi i tyre. Qasja e auditimit të brendshëm ishte e bazuar në rreziqe dhe në operacionet e përditshme të Organizatës.

Komiteti i auditimit kishte mbajtur takime të rregullta dhe kishte shqyrtuar të gjitha raportet e NJAB.

3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2019 të MF-së ka rezultuar me gjashtë (6) rekomandime kryesore. MF kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna si dhe me datën 27.09 2019 MF kishte përgatitur dhe dorëzuar në ZKA raportin periodik për progresin e zbatimit të rekomandimeve.

Deri në fund të auditimit për vitin 2019, katër (4) rekomandime ishte zbatuar, një (1) rekomandim e kemi trajtuar si rekomandim të mbyllur dhe një (1) nuk është adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Tabelën e rekomandimeve nr.4.

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2019

Nr.	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2018	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	Procesi i buxhetit	Ministri duhet të siguroj se me rastin e përgatitjes së buxhetit vjetor, janë kryer analiza të hollësishme, duke iu referuar edhe të dhënave historike të viteve të fundit. Gjithashtu, të bëhet analiza dhe prioritizimi i projekteve për të cilat ekzistojnë të gjitha parakushtet që të njëjtat të fillojnë me procesin e realizimit gjatë vitit. Veç kësaj, njësitë kërkuese duhet që me kohë të procedojnë kërkesat për realizimin e projekteve.	Rekomandimi nuk është zbatuar mirëpo dhe për nga natyra apo koha janë përfundimisht të pazbatuara Ref. B1.4_1 LP_buxheti dhe realizimi	Rekomandimi mbyllur
2	Pagat dhe mëditjet	Ministri duhet të ndërmarrë të gjitha veprimet e duhura që të eliminohen arsyet apo pengesat e plotësimit të pozitive të lira, posaçërisht pozitive kyçe.	Si rezultat i mostrave të ekzaminuara edhe këtë vit kemi identifikuar mangësi të këtij lloji në këtë komponentë Ref B3	Rekomandimi pa zbatuar - i përsëritur. Rekomandimi B1 në këtë raport.
3	Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investime kapitale	Ministri duhet të siguroj bashkëpunim më të ngushtë ndërmjet të gjitha palëve pjesëmarrëse në proces, që nga bërja e porosive deri të aktivitetet e kontrollit rreth realizimit të pagesave, në mënyrë që ato të procedohen sipas rregullave në fuqi.	Si rezultat i mostrave të ekzaminuara në këtë kategori këtë vit nuk kemi identifikuar mangësi të këtij lloji në këtë komponentë Ref. B4	Rekomandimi zbatuar
4	Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investime kapitale	Ministri duhet të sigurojë bashkëpunim më të ngushtë ndërmjet komisioneve të vlerësimit dhe zyrtareve të prokurimit, me qëllim të ngritjes së përgjegjësisë tek komisionet, në mënyrë që vlerësimet të bëhen duke u bazuar në kriteret e vendosura në dosje të tenderit, dhe jo në bazë të kapaciteteve profesionale e teknike të OE-ve për të kryer punë.	Si rezultat i mostrave të ekzaminuara në këtë kategori këtë vit nuk kemi identifikuar mangësi të këtij lloji në këtë komponentë Ref. B5	Rekomandimi zbatuar

5	Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Ministri duhet të siguroj bashkëpunim të ngushtë ndërmjet zyrtarit të pasurisë dhe komisionit, për përfundimin e raportit të inventarizimit në kohën e përshtatshme para përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore, në mënyrë që të pasqyrohet gjendja e saktë e pasurisë.	Kemi verifikuar raportet e inventarizimit dhe jemi siguruar se të njëjtat janë kryer para përgatitjes së PVF-fe Ref.B7.4 Raporti I Inventarizimit	Rekomandim i zbatuar
6	Auditimi i Brendshëm	Ministri duhet të stimuloj dhe mbështesë punën e KA, në mënyrë që të sigurohet se roli dhe misioni i KA në ministri po përmbushet dhe funksioni i auditimit të brendshëm është i monitoruar mirë.	Është formuar komiteti i auditimit ref. B10.5e	Rekomandim i zbatuar
Nr.	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2019		
1	Mallra dhe shërbime	Ministri duhet të siguroj se do të merren masa që brenda një periudhe të shkurtër kohore të sqarohet problemi me avanse dhe se të gjitha llogaritë e viteve paraprake të mbyllen.		
2	Investime Kapitale	Ministri, duhet të siguroj që gjatë proceseve të prokurimit, Departamenti përkatës dhe personat tjerë të përfshirë në proces (komisioni i vlerësimit), të respektojnë në mënyrë të plotë kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë.		
3	Subvencione dhe Transfere	Ministri duhet të siguroj se në bashkëpunim me OB përkatëse, të bëj identifikimin dhe vlerësimin e kërkesave për projektet që drejtohen në MF dhe ZKM dhe bazuar në vlerësimin e bërë për këto projekte, ato të planifikohen në buxhetin e rregullt të organizatave përkatëse buxhetore. Gjithashtu, të sigurohet se mjetet nga rezervat, duhet të ndahen vetëm për raste të paparashikuara (urgjente), në pajtueshmëri me procedurën e kërkuar në LMFPP		
4	Pasuritë kapitale dhe jokapitale	Ministri në bashkëpunim me menaxhmentin e NjIF duhet t'i rishikojnë kontrollet ekzistuese në menaxhimin e pasurisë. Kontrollet në këtë fushë duhet të forcohen në mënyrë që pasuritë të regjistrohen si duhet dhe të ruhen nga humbja dhe keqpërdorimi.		

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pamodifikuar** nëse arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse Pasqyrat Financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në Pasqyrat Financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale, por nuk janë përhapur në Pasqyrat Financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë materiale, por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në Pasqyrat Financiare.

155. Auditori duhet të japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë, edhe materiale, edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi Pasqyrat Financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë Pasqyrat Financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhen t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të Pasqyrave Financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letër Konfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo Ministria e Financave / Ministrstvo za Financije Ministry of Finance Arkiva - Arhiva - Archive	
Nr. Shk. / Doc. No. / Org. Unit:	01
Nr. Prot. / Prot. No. / Proc. No.	880
Nr. i kopjeve / No. of copies / No. pages:	13.07.2020
Datimi / Date:	PRISTINE/A



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave
Ministarstvo za Financije - Ministry of Finance

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2019 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Prishtinë, datë: 13.07.2020

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare Vjetore të Ministrisë së Financave, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Hykmete Bajrami

Ministre e Ministrisë së Financave.

